



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br	94/14
Nr. i fq. / Br. st	- 9 -
Data: / Datum	24.04.2014
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e III-të e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,
mbajtur më 27.03.2014

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:05.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:
Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Plana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gérxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Hysni Gërguri dhe Mentor Ferizi, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkyetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – për në “të ndryshme” propozoi të futen këto pikat:

- a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e teatrit të qytetit.
- b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aplikim për grantin e shpallur nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të ujites në fshatin Pantinë.
- c. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërim.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se në mbledhjen e kaluar të KK-së ka kërkuar informatë për pronat e Komunës së Vushtrrisë, të cilat i kanë në shfrytëzim, kurse ia kanë sjellur një informatë vetëm për pronat bujqësore, prandaj përsëri kërkoi informatë për të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, duke përfshirë afatin kohor të shfrytëzimit dhe mënyrën e pagesës. Pastaj tha se Grupi kuvendar i LDK-së kërkon që hiqet pika nr. 10 e rendit të ditës, pasi që nuk është përgatitur siç duhet, dhe i njëjti nuk ka kaluar përmes KPF-së, prandaj kërkoi që për mbledhjen e ardhshme të KK-së të përgatitet siç duhet dhe të procedohet në mënyrë të rregullt. Ndërsa pikat shtesë të rendit të ditës të propozuara nga kryesuesi, tha se nëse janë urgjente mund të shqyrtohen.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit- tha se pas zhvillimeve të fundit lidhur me propozimin e anëtarëve nga AAK-ja për komitetet obligative, Grupi kuvendar i AAK-së propozoi anëtarë tjerë, nga ata për të cilët ishin dakorduar paraprakisht, prandaj si rezultat i mos respektimit të marrëveshjes paraprake nga Grupi kuvendar i AAK-së, njoftoi se që nga sot nuk është anëtare e Grupit kuvendar të AAK-së, duke shtuar se faktorë kryesor për largimin e saj janë veprimet jodemokratike nga grupi kuvendar në fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me rendin e ditës, tha se pikë nr. 10 është dashëtë të përgatitet më mirë si material, dhe dokumenti të jetë i nënshkruar nga anëtarët e komisionit, prandaj kërkoi që propozim-vendimi në fjalë të përgatitet mirë dhe të mos ndodh që të jepen me dhjetëra dhe qindra hektarë dhe të mos e paguajnë qiranë. Pastaj lidhur me ndërtimin e fabrikës së ujit, tha se qytetarët duhet të informohen saktë se kur do të finalizohen punimet në ndërtimin e fabrikës së ujit, duke shtuar se nga organet komunale ka marrë një përgjigje që është shqetësuese, pasi që gjendja e punimeve është në disproporcione me atë që ka thënë kryetari i komunës, sepse duke iu referuar përgjigjes që ka marrë, për ta përfunduar ndërtimin e fabrikës së ujit, firmës "Rukolli" i nevojiten edhe 294 ditë pune, pasi që dimri paska qenë i vështirë, prandaj shtoi se nuk duhet të luhet me një çështje kapitale siç është furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm. Mandej ngriti çështjen e zvarritjes së emërimit të rrugëve dhe shesheve në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë, prandaj pyeti se si qëndron puna rreth kësaj çështjeje. Në fund kërkoi informatë për çështjen e ndërtimit të objekteve shumëkatëshe, dhe se të njëjtat a përpushten me lejet e ndërtimit?

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar pikës nr. 10 të rendit të ditës, tha se nuk është e drejtë që të aprovohet propozim-vendimi në fjalë, pa u precizuar parcelat.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- paraqiti sqarime shtesë lidhur pikën nr. 10 të rendit të ditës, si dhe lidhur me propozimet për pikat shtesë të rendit të ditës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me 23 vota "për", 7 kundër, të tjerat "abstenim" miratoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në vitin 2013 (kryetari i komunës).
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përcaktimin e kritereve për sigurimin e strehimit për kategoritë sociale- shqyrtimi i dytë (Drejtoria për Shëndetësi).
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e transportit në territorin e Komunës së Vushtrrisë- shqyrtimi i parë (Drejtoria për Shërbime Publike).
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zhvillimin (realizimin) e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun (DKRS).
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore.
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë.
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat në fshatin Stroc.
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me statusin e paluajtshmërisë së Stacionit të Autobusëve.
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës- tokës bujqësore dhe kullosat.

11. Të ndryshme:

- a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e teatrit të qytetit.
- b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aplikim për grantin e shpallur nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të ujites në fshatin Pantinë.
- c. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërim.
- ç. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- kërkoi që të plotësohet diskutimi i tij për pikën nr. 3 të rendit të ditës.

Aprovohet unanimisht procesverbal i një fjalë, me vërejtjen e I.Gashit.

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në vitin 2013 (kryetari i komunës).

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se shihet se shumë objektiva janë realizuar, por në të njëjtën kohë shumë objektiva kanë mbetur të parealizuara, dhe përmendi se ka rënje në inkasimin e të hyrave vetanake në këtë vit, sikurse në vitin e kaluar. Pastaj tha se edhe përkundër marrjes së vendimit për ndarjen e parcelës, nuk dihet pse është heshtur çështja e ndërtimit të kompleksit banesor për familjet e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të luftës dhe familjeve pa strehë. Mandej lidhur me punimet në fabrikën e ujit ku thuhet se në këtë vit ka qenë dinamikë e shtuar e punimeve, shtoi se ka qenë dinamikë e zvogëluar. Në vazhdim lidhur me listën e projekteve të realizuara, kërkoi që në të ardhmen të përmendet edhe muaji i realizimit të projekteve, si dhe kërkoi që të dihet se disa mjete financiare kah janë bartur dhe kah janë kryer disa projekte. Pastaj tha se te Drejtoria për Kadastër dhe Pronë shihet se janë 21 lëndë për shpronësimet dhe uzurpimet, por nuk ka ndarje sa prej tyre janë për shpronësime, e sa për uzurpime, si dhe çfarë sipërfaqe është liruar. Gjithashtu tha se është anomali kur shumë projekte dalin me shifër të barabartë të shpenzimeve. Po ashtu është e paqartë se kush është furnizuar me gypa, pasi që nuk përmenden përfituesit e tyre. Në fund lidhur me ndërtimin e rrugëve, pyeti se a ka shkuar gjithçka sipas procedurave, pasi që nuk përputhen shifrat me numrin e tenderëve të paraqitura në raport nga Drejtoria për Prokurim.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë ku flitet për Qendrën për Punë Sociale, tha se termi "shfrytëzues" duhet të zëvendësohet me termin "familje". Po ashtu nuk janë përmendur dy kategoritë e atyre që marrin ndihmë sociale, si dhe nuk dihet se sa familje marrin asistencë sociale të ndara nëpër këto dy kategori. Pastaj tha se është e pakuptimtë që brenda një viti të shkon në komisionin mjekësor 5 herë e njëjta lëndë. Në vazhdim propozoi që të hartohej një pilot projekt, përmes të cilët kategoria e dytë të kalon në zyrën e punësimit, e që me ato të holla do të ndërtohej qyteti, pasi që shfrytëzuesit e kategorisë së dytë do t'i marrin të hollat me punën e tyre, duke i angazhuar përmes kontratës mbi vepër për të pastruar qytetin dhe lumenjtë. Në fund tha se në raport mungon edhe numri i familjeve që jetojnë me gjendje të rëndë sociale.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se rapporti në fjalë nuk përban parametra matës, të cilët do të tregonin se cilat punë apo shërbime janë kryer më mirë, por thuhet se është ngritur niveli i cilësisë në ofrimin e shërbimeve në shëndetësi, por shtoi se në realitet nuk është ashtu, pasi që qytetarët vazhdimisht ankohen për këto shërbime, duke njofuar se në QKMF nuk punon laboratori për analiza. Pastaj në raport thuhet se ka qenë në nivel bashkëpunimi me institucionet qendrore, por e vërteta është se nuk ka qenë në

nivel, pasi që nuk mund të jetë bashkëpunimi në nivel, kur nuk respektohen vendimet e institucioneve qendrore, siç ka ndodhur që qeveria lokale nuk i ka zbatuar këto vendime në mandatin e kaluar. Mandej në raport thuhet se është arritur qëllimi lidhur me transportimin e nxënësve, por shtoi se në kuvendin e komunës është potencuar se nxënësit transportohen në mënyrën më të keqe, me numër të mbingarkuar të nxënësve dhe shpesh së bashku edhe me udhëtarë të tjerë. Po ashtu në raport thuhet se janë ndihmuar shoqatat, por pyeti se sa është interesuar qeveria lokale për individët e këtyre shoqatave, duke përmendur rastin e pjesëtarit të UÇK-së nga fshati Shilovicë, i cili jeton në kushte mizore. Në vazhdim ngriti shqetësimin për mospërputhjen e të dhënave në raportin në fjalë me pasqyrat financiare, duke përmendur si shembull shpenzimet e karburanteve, ku në raport ceket se janë shpenzuar afér 34.000 €, kurse tek pasqyrat financiare për të njëjtin pozicion del shuma prej 27.675 €. Gjithashtu tha se në raport ka shumë projekte kapitale të kryera, kurse në pasqyrat financiare nuk ka pas fare ndërtim të rrugëve. Po ashtu tha se ka mospërputhje brenda raportit në fjalë në mes të statusit të lëndëve të zgjedhura nëpër drejtori. Pastaj tha se ekziston një kaos urbanistik, i cili është krijuar si pasojë e mosbatimit të vendimeve që vijnë nga lartë për planet rregullative, të cilat i ka anuluar Inspektorati i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, po ashtu ka një degradim të tokës bujqësore në tërë komunën, e posaçërisht gjatë magjistrales, duke shtuar se çdo ditë ndërtohet pandërprerë. Në fund tha se në bazë të të dhënave të paraqitura në këtë raport, nuk mund të konstatohet se këto të dhëna janë të besueshme, për shkak se nuk përputhen me të dhënat në pasqyrat financiare dhe të dhënat brenda raportit.

Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit- lidhur me personat me aftësi të kufizuara, e posaçërisht personat me sindromin DAWN, pyeti pse iu ndërpren pagesa kësaj kategorie, pasi që ta arrijnë moshën 18 vjeçare, duke shtuar se Qendra për Punës Sociale duhet të merret me këtë kategori duke i aftësuar për të kryer punë të pavarura.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- tha se në raportin në fjalë shihet se as kryetari i komunës nuk është i kënaqur me ngritjen e performancës në mbrojtjen e pyjeve, prandaj kishte me qenë mirë që kryetari ta paraqet një informatë për ta kuptuar se cilat janë problemet që performanca në mbrojtjen e pyjeve nuk është në nivel. Kurse sa i përket klimës për të bërë biznes, tha se nuk është punuar sa duhet në këtë drejtim. Po ashtu kërkoi që të ndërmerren masa në riparimin e rrethojës së lumbit "Tërstenka", pasi që e njëjta çdo ditë po dëmtohet. Gjithashtu kërkoi që të pastrohet sipërfacja përreth hekurudhave, pasi që po krijohen deponi ilegale të mbeturinave. Në fund propozoi që kompania "Uniteti" të transferohet në kompani kommunale.

Ergin Suguri, anëtar i kuvendit- lidhur me raportin në fjalë, tha se është dashtë të ceket numri i të punësuarëve në Zyrën për Komunitete dhe cilat komunitete janë të punësuara në zyrën në fjalë, si dhe është dashtë të publikohet se cilat komunitete kanë nevojë për ndihma.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë i lejon dy procedura të prokurimit: çmimi më i ulët i përgjegjshëm dhe çmimi ekonomikisht më i favorshëm i operatorëve të përgjegjshëm. Pastaj tha se Komuna e Vushtrrisë prin si lidere, ku shumë autoritete kontraktuese e vlerësojnë si shembull pozitiv, prandaj e përkrah raportin në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- paraqiti sqarime shtesë, si dhe iu përgjigj pyetjeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me raportin në fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me punimet në fabrikën e ujit, tha se punëkryerësi firma "Rukolli" ka lidhur kontratë 3-vjeçare (më: 10.11.2010) për ndërtimin e kësaj fabrike, por në këtë periudhë nuk janë kryer punët, mirëpo pas skadimit të kontratës për kryerjen e punimeve, në ndërkohë kjo firmë ka kërkuar nga Ministria e Financave zgjatjen e afatit nga pamundësia e kryerjes së punëve gjatë sezonës së dimrit, dhe kërkesa është aprovuar për zgjatje të afatit edhe për 294 ditë pune. Në fund tha se është një lutje e qytetarëve për një kanalizim që ka shpërthyer që disa ditë mbrapa "Unikonzum"-it, prandaj kërkoi që të rregullohet sa më shpejt.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- sqaroi se firma “Rukolli” edhe gjatë sezonës së dimrit ka punuar nonstop në ndërtimin e fabrikës së ujit.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me raportin në fjalë për Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë thuhet që në procedurë janë edhe 41 lëndë, kurse në tabelën në të cilën raportohet, e që i përmblehdh Drejtoria për Administratë thuhet se nuk është asnjë, dhe gati e njëjtë situatë është edhe te Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar sqarimeve që i kërkoi I.Gashi, kërkoi që drejtoritë përkatëse të paraqesin informatë me shkrim për I.Gashin.

3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përcaktimin e kritereve për sigurimin e strehimit për kategoritë sociale- shqyrtimi i dytë (Drejtoria për Shëndetësi).

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto propozime: te neni 9.8 është dashtë të ceket përqindja e invaliditetit dhe numri i anëtarëve të paftë të familjes; te neni 16.3 të shtohet fjalia “si dhe certifikata për të gjithë anëtarët tjerë mbi moshën 18 vjeçare”, po ashtu të kërkohet edhe dëshmia se nuk posedon pronë dhe nuk ka përfituar nga ndonjë proces i rindërtimit, si dhe të shtohet dëshmia për kohëzgjatjen e banimit në qendrat kolektive të banimit (baraka).

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit- tha se draft-rregullorja në fjalë ka shumë mangësi, dhe e njëjtë duhet t'i dedikohet vetëm rasteve me gjendje të rëndë sociale dhe rasteve me asistencë sociale. Pastaj tha se duhet të hiqet pjesa ku përmendet si kriter moszgjidhja e çështjes së banimit, sepse këtu mund të futen shumë kategori, përmes së cilave përfitojnë pushtetarë dhe zyrtarë në kurriz të të varfërve. Po ashtu propozoi që të hiqet qiraja për rastet sociale, dhe ajo mund të jetë një shumë simbolike prej 1 euro, pasi që shuma prej 40 euro është shumë e lartë, kur merret parasysh që në Vushtrri mund të gjenden banesa me 50-100 euro me qira. Te neni 8 duhet të hiqet pjesa: “nuk e ka të zgjidhur çështjen e banimit” dhe kjo të ketë kuptim vetëm nëse rastet e rënda apo në asistencë sociale, që ndër të tjera nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, dhe kjo të mos bëhet kategori e veçantë, sepse mund të keqpërdoret. Mandej tha se posedimi i pronës nuk duhet të jetë pengesë për mos marrien e banesës, por ajo duhet të rregullohet në atë mënyrë që p.sh. nëse dikush i ka 3 hektarë tokë mund ta shes tokën për të ndërtuar shtëpi, por dikush me 1-50 ari tokë nuk duhet ta ketë problem për të marrë banesë sociale, nëse kushtet i ka të vështira, dhe kjo varet edhe nga çmimi i tokës, gjithashtu duhet të merret për bazë konteksti social, ekonomik e kulturor, që nënkupton se shumica mund të kenë ngapak tokë, por kjo mos t'i ndalojë në të drejtën për qasje në banim social, si dhe duhet ngritur çështjen që këto banesa dhe banime të mos janë të veçuara nga lagjet tjera, por të ndërtohen në atë mënyrë që të mundësojnë banime të përziera, pasi që nëse ndërtohen bloqe të banesave vetëm për këto kategori, atëherë po krijohen lagje të varfra, e që paraqet diskriminim. Te neni 9, tha se kriteret janë të paqarta për disa kategori, pasi që nuk është përfshirë kategoria e familjeve që nuk kanë të ardhura, por janë të varfra dhe të njëjtat nuk mund të marrin asistencë sociale për shkak të kritereve të përcaktuara nga ministria, prandaj duhet shikuar me kujdes që të mos përjashtohen të varfrit vetëm pse nuk janë pjesë e kategorisë së asistencës sociale. Te paragrafët 9.9 dhe 9.10, tha se janë të padrejtë, sepse nëse dikush jeton në kushte higjienike të rënda apo që banesa është duke iu shembur dhe s'ka ku të strehohet, komuna është e obliguar edhe sipas statutit që t'i sigurojë strehim, prandaj poentimi me nga 2 pikë për këta dy paragraf është i pakuptimitë dhe diskriminues. Në fund lidhur me paragrafin 9.14, tha se për të mosuarit për të cilët nuk përkujdeset askush, komuna duhet t'ua siguroj strehimin dhe të ketë kujdes permanent për ta, e jo të veprohet ashtu siç është paraparë me këtë draft-rregullore, ku kjo kategori poentohet me poena fyes me 1 pikë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për përcaktimin e kritereve për sigurimin e strehimit për kategoritë sociale, duke inkorporuar propozimet e arsyeshme nga anëtarët e KK-së.

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e transportit në territorin e Komunës së Vushtrrisë- shqyrtimi i parë (Drejtoria për Shërbime Publike).

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit- kërkoi që diskutimi publik të organizohet në mënyrë transparente për të gjitha grupet e interesit duke filluar nga autobusët, kombibusët dhe taksistët.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për organizimin e transportit në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 28.03.2014 dhe zgjatë deri më 16.04.2014.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zhvillimin (realizimin) e aktiviteteve kulturore, rimore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun (DKRS).

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, kërkoi sqarim pasi që në bazë të një përllogaritjeje nga të dhënat e paraqitur në tabelë kanë dal mbi 105 hektarë që janë dhënë në shfrytëzim, kurse në hyrje të informatës thuhet se deri në tetor të vitit 2012-2013 janë dhënë në shfrytëzim 70.86.05 ha.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë, tha se në informatë figuron një person që ka marrë rrëth 41 hektarë, dhe i njëjtë nuk ka përbushur obligimet, prandaj kërkoi që komisioni ta kryen punën siç duhet, pasi që nëse analizohen emrat e publikuar në këtë tabelë, atëherë shihet dhe zbulohet shumëcka, dhe për këtë arsy kërkoi që t'i u jepet atyre që vërtet janë kontribut për këtë popull, dhe të njëjtë mund të punojnë për interesin e qytetarëve dhe të komunës sonë. Pastaj pyeti rrëth një prone prej 23-25 hektarë tokë, e cila është mbi fshatin Gracë, të cilën dikur e ka shfrytëzuar kombinat i Obiliqit, dhe në ndërkohë ka ardhur një qytetar nga fshati Dumnicë dhe ka njoftuar se e njëjta tokë evidentohet në emër të Komunës së Vushtrrisë, prandaj pyeti se ata hektarë a janë në emër të Komunës së Vushtrrisë?

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se dhënia e pronës në shfrytëzim, duke përfshirë edhe tokën bujqësore realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme, ku së pari shpallet oferta-tenderi dhe përzgjidhen personat fizikë që kanë ofertë më të mirë për interesin e komunës. Po ashtu sqaroi se pjesë përbërëse e 41 hektarëve janë edhe 23 hektarët e fshatit Gracë, e cila është tokë komunale, dhe shtoi se fakti që Esat Jusufi nuk ka paguar rregullisht shfrytëzimin e tokave bujqësore, iu është shkëputur kontrata dhe përsëri ritenderohen ato parcela.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim aprovohet Plani Lokal për Veprim në Mjedis për territorin e Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2013-2018, i cili ka për qëllim krijimin e bashkëpunimit midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit lokal dhe atij qendrор.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat në fshatin Stroc.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, kërkoi sqarim se a do të ketë pengesa, pasi që përmendet Zona Kadastrale në Gllavotin, kurse bëhet fjalë për varrezat e fshatit Stroc.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit- lidhur me pyetjen e I.Gashit, sqaroi se parcela kadastrale e paraqitur në propozimin-vendimin në fjalë territorialisht ndodhet në fshatin Stroc, kurse është e evidentuar si parcelë kadastrale në Zonën Kadastrale në Gllavotin. Në fund kërkoi që propozim-vendimi në fjalë të aprovohet.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se është një çështje sensitive, prandaj duhet të jetë proces transparent dhe në pajtim të plotë me tërë komunitetin për caktimin e këtij lokacioni për varreza të përcaktuar në propozim-vendimin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim caktohet lokacioni për varrezat e fshatit Stroc pjesë nga parcela kadastrale P-70202017-00565-0 në sipërfaqe prej 7300 m², në sipërfaqe të përgjithshme prej 102233 m², me kulturë "kullosë" e klasës së 5-të, Zona Kadastrale Gllavatin, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me statusin e paluajtshmërisë së Stacionit të Autobusëve.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se në informatën në fjalë nuk ceket një akt i pranim-dorëzimit i datës 12.06.2012, që është bërë përmes Zyrës Regionale të AKP-së në Mitrovicë dhe Komunës së Vushtrrisë, prandaj pyeti se a ka pas ndonjë akt nënshkrimi, sepse edhe në mjete të informimit është lansuar lajmi si i tillë nga zënëdhësi i komunës. Në fund i kundërshtoi dy alternativat e paraqitura nga hartuesi i informatës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se në mandatin e kaluar të kuvendit të komunës është formuar një bord, i cili kishte në përbërje anëtarë të institucioneve lokale dhe partisë në pushtet. Pastaj tha se pa ekzistuar mjetet financiare edhe në të kaluarën nuk ka qenë e mundur të realizohet ekspropriimi, prandaj nënkuptoher që ato mjete kanë qenë të siguruara, duke shtuar se me ndihmën e institucioneve ndërkombëtare ka mundësi që të shikohen dhe vërtetohen të gjitha dokumentet relevante për të kuptuar se ndoshta nga buxheti komunal i asaj kohe është bërë pagesa, dhe në këtë mënyrë të kuptoher gjendja reale.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- shpjegoi procedurat e transferimit të stacionit të autobusëve nga AKP-ja në pronësi komunale, dhe sqaroi se nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje, por ka qenë vetëm një akt.

Idriz Muzaqi, përgjegjës i Zyrës Ligjore- paraqiti sqarime shtesë lidhur me informatën në fjalë.

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës- tokës bujqësore dhe kullosat.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se Grupi kuvendar i LDK-së edhe në fillim kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë e rendit të ditës, pasi që nuk i plotëson kushtet për shqyrtim, dhe kërkoi që nen 2 i propozim-vendimit në fjalë të ndryshohet, pasi që nuk lejohet që të jepet në shfrytëzim prona komunale, pa e përcaktuar në mënyrë të detajuar çdo parcelë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, kërkoi që të respektohen procedurat në mënyrë që gjithçka të jetë transparente, si dhe dokumenti të jetë i nënshkruar nga komisioni. Gjithashtu kërkoi të mos përsëriten gabimet e së kaluarës, siç ka ndodhur që janë dhënë pronat në shfrytëzim pa shpallje publike.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Propozim-vendimi në fjalë shtyhet për t'u shqyrtuar në mbledhjen e ardhshme të KK-së dhe i njëjtit të përgatitet më mirë.

11. Të ndryshme:

a. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e teatrit të qytetit.**

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim themelohet Teatri i qytetit të Vushtrrisë.

b. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aplikim për grantin e shpallur nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të ujitjes në fshatin Pantinë.**

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim Komuna e Vushtrrisë merr obligim për participim me mjete financiare nga buxheti komunal në masën prej 20 % apo në vlerë monetare prej 28,931.07 €, nga vlera e përgjithshme e projektit “përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të ujitjes”.

c. **Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërim.**

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - fondi për subvencione për Isa Hajrizin, me banim në Vushtrri, në shumën prej 2.500 € (dy mijë e pesëqind euro).

Shuma e cekur ndahet për operim, me qëllim të shërimit të plagëve të luftës.

ç. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit- njoftoi se me 23 prill është Dita Memoriale e Turqve të Kosovës, me ç'rast do të organizohen disa aktivitete kulturore dhe sportive. Pastaj propozoi që Komuna e Vushtrrisë ta formon Zyrën e Protokollit, në mënyrë që të organizohen sa më mirë vizitat e ndryshme nëpër përvjetor, si dhe të shërben për mirëmbajtjen e flamujve kombëtar dhe shtetëror.

Zoran Rakic, anëtar i kuvendit- tha se Kooperativa Bujqësore gjendet në procesin e privatizimit, e cila ndodhet në Zonën Kadastrale të Prilluzhës, edhe pse një pjesë e kësaj kooperative është e shitur, dhe në të ardhmen edhe pjesa tjetër pritet të shitet dhe e cila më shumë është tokë ndërtimore, se sa bujqësore, ku edhe gjendet Qendra për Kulturë, Fabrika e Poletit, Kisha dhe varrezat, prandaj pyeti se për mbledhjen e ardhshme të KK-së a mund të paraqitet si propozim që këto parcela të tërhiqen nga privatizimi i tokës, dhe komuna t'i shfrytëzon këto toka bujqësore.


Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit- kërkoi për mbledhjen e ardhshme të KK-së informatë nga kryetari i komunës lidhur me kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë nga të gjitha bizneset, ku duhet të përfshihen emri dhe mbiemri i të gjithë atyre që kanë borxh mbi 100 euro.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar pyetjes së Z.Rakicit, tha se kuvendi i komunës mund ta shpallë zonë me interes të përgjithshëm, dhe pastaj duhet të bëhet kërkesë në ministri, ku bëhet vlerësimi nga komisioni, dhe pastaj me lejimin e komisionit bëhet këmbimi i pronës apo pagesa e saj, dhe shtoi se komunat në Kosovë janë zhveshur nga mundësia për shfrytëzimin e hapësirave tokësore për interesa publike të qytetarëve, duke shtuar se komuna ka shpallë zona të tilla, por AKP-ja nuk i ka aprovuar.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të AAK-së kërkoi informatë me shkrim për dy konkursset e fundit, duke përfshirë emrat e atyre që janë pranuar, si dhe a është anuluar ndonjë pozitë e shpallur me konkurs.

Mbledhja përfundoi në orën 12:17.

Procesmbajtësi


Albanez Tahiraj

